

Titulli i lëndës: KIMI ANALITIKE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Mjekësisë - Farmaci
Titulli i lëndës:	Kimi Analitike
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i I-rë Semestri i II-të
Numri i orëve në javë:	2+1+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	E Hënë 08:45-11:00
Mësimdhënësi:	Prof. Ass. Dr. Liridon Berisha
Të dhënat kontaktuese:	Liridon.berisha@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Aplikimi i njohurive nga ekuilibrat kimik dhe reaksioneve kimike në analizën kimike të lëndës. Në kuadër të lëndës shtjellohen hapat në procedurën e analizës kimike, gabimi eksperimental dhe përpunimi statistikorë i rezultateve të analizës. Të kuptuarit e hapave në procedurën e analizës kimike e përforcon trajtimi i ekuilibrave për lloje të ndryshme të reaksioneve kimike si ato acido bazike, kompleksimit, precipitimit dhe oksido reduktimit të cilat përdoren në kuadër të metodave vëllimetrike dhe gravimetrike të analizës kimike.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor është zhvillimi i aftësive të studentit për realizimin e një analize kimike me metodat përkatëse duke përfshirë analizën cilësore dhe ato sasiore të analitëve inorganik dhe organik. Zhvillimi i shkathtësisë së zgjidhjes së problemeve në kuadër të analizës kimike dhe përvetësimi i teknikave laboratorike të cilat zbatohen në analizën cilësore dhe sasiore. Studentët me punën e tyre që zhvillojnë në këtë kurs do të jenë në gjendje të identifikojnë mundësitë e gabimeve gjatë një analize kimike gjithashtu, krijimin e shprehive dhe shkathtësive për punë të pavarur eksperimentale, përdorimin e drejtë të mjeteve laboratorike përkatëse në kushte dhe situata të ndryshme eksperimentale.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - Kupton dhe aplikon konceptet bazë të Kimisë Analitike në hapat e procedurës së analizës kimike - Analizon dhe llogarit rezultatet e analizës kimike eksperimentale - Aplikon përpunimin statistikor të rezultateve dhe krahason metodat analitike - Kupton procesin e përgatitjes dhe zgjedhjes e metodës analitike - Zbaton ekuilibrat kimik në analizën kimike - Aplikon përdorimin e metodave klasike në analizën kimike

Obligimet e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)																	
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej														
Ligjëratat	2	15	30														
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	1	15	15														
Punë praktike	2	15	30														
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	6	3														
Puna në terren	0	0	0														
Testi, punimi seminarik	10	1	10														
Detyrë shtëpie	1	10	10														
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30														
Përgatitja për provimin final	5	3	15														
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4														
Projektet, prezantimet, etj.																	
Total			147														
Metodat e mësimdhënies:	Studentët shfletojnë materialin para ligjëratis dhe përmes shembujve dhe dhe zgjidhjes së problemeve sqarohen dhe përforcohen njohuritë e studentëve. Në ushtrime eksperimentale studentët arrijnë aplikimin e njohurive teorike në punë laboratorike duke realizuar analizën kimike.																
Metodat e vlerësimit:	<table> <tr> <td>Vlerësimi I</td> <td>15 %</td> </tr> <tr> <td>Vlerësimi II</td> <td>15 %</td> </tr> <tr> <td>Detyrat e shtëpisë/kuize</td> <td>5 %</td> </tr> <tr> <td>Seminari</td> <td>5 %</td> </tr> <tr> <td>Ushtrimet laboratorike</td> <td>30 %</td> </tr> <tr> <td>Provimi pefundimtare</td> <td>30 %</td> </tr> <tr> <td>Numri total i pikeve</td> <td>100%</td> </tr> </table>			Vlerësimi I	15 %	Vlerësimi II	15 %	Detyrat e shtëpisë/kuize	5 %	Seminari	5 %	Ushtrimet laboratorike	30 %	Provimi pefundimtare	30 %	Numri total i pikeve	100%
Vlerësimi I	15 %																
Vlerësimi II	15 %																
Detyrat e shtëpisë/kuize	5 %																
Seminari	5 %																
Ushtrimet laboratorike	30 %																
Provimi pefundimtare	30 %																
Numri total i pikeve	100%																
Literatura primare:	Daniell C. Harris, Quantitative Chemical Analysis 10th ed. 2019 W. H. Freeman																
Literatura shtesë:	D. Harvey: Modern Analytical Chemistry, Mc Graw Hill, Boston, 2000.																
Hartimi i planit mësimor																	
Java	Titulli i ligjëratis																
Java 1:	Hyrje: Procesi analitik dhe matja																
Java 2:	Mjetet e punës																
Java 3:	Gabimi eksperimental																
Java 4:	Statistikat																
Java 5:	Tretshmeria dhe precipitimi																
Java 6:	Tretshmëria dhe precipitimi																
Java 7:	Metodat gravimetrike																
Java 8:	Vlerësimi I																
Java 9:	Kalibrimi, standardizimi, blanko, regresioni linear																
Java 10:	Ekuilibrat kimik																
Java 11:	Aktiviteti dhe trajtimi sistematik i ekuilibrave																

Java 12:	Ekulibrat acido-bazik, puferet
Java 13:	Metodat titrimetrike I
Java 14:	Metodat titrimetrike II
Java 15:	Vlerësimi II

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Afati kohorë për dorëzimin e detyrave është 7 nga dita kur ipen detyrat.

Detyrat të cilat dorezohen me vonëse nuk do te vleresohen me pike.

Kuizet online do të organizohen brenda një intervali kohorë 1 deri 2 orë brenda javës.

Seminaret e zgjedhura duhet të dorëzohen deri në javën e 11 dhe të mbrohen para javës së 15.

Ndalohet përdorimi nga ana e studenteve i telefonave celular, dhe të gjitha mjeteve tjera te teknologjise informatike si kompjutere laptop, tablet etj. Vetëm në rastet kur lejon mësimdhënësi.

Telefonat mund te perdoren vetem ne rastet emergjente jashte nga klasa me leje te mësimdhënësit.

Studentet duhet te mbajnë qetesine gjate leksioneve.

Studenti para se të filloj punën eksperimentale duhet të kuptoj qëllimin e eksperimentit dhe objektivat të cilat do të arrihen nga eksperimenti. Studenti vlerësohet nga asistenti për njohuritë e tij para se të filloj punën në laborator dhe kalueshmëria është kusht për zhvillimin e eksperimentit.

Mos respektimi i rregullave rezulton me perjashtim nga mundesia e hyrjes në provim perfundimtar.